

VENDIM
Nr. 131, datë 13.9.2012

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SEAMENT ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 8, 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Seament Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Seament Albania” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Seament Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani